

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, i përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrie Krasniqi-Sheholli dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.M. me vendbanim në P., rr:”...”, pnr., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së dhe H.H. me vendbanim në P., rr:”...”, pnr., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1896/2017 të dt.17.05.2018 pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, më dt.01.04.2019 në praninë e Prokurorit të Shtetit Rexhep Maqedonci dhe të akuzuarve, të njëjtën ditë në prezencë të palëve mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.04.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

B.M., nga i ati F. dhe e ëma F., mbiemri i vajzërisë së nënës D., i lindur më datë *data e lindjes...*, me vendbanim në P., rr:”...”, pnr., ka të kryer shkollën e mesme, student, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, i pa martuar, sipas të dhënave penale të kësaj gjykate nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

H.H. nga i ati S. dhe e ëma M., mbiemri i vajzërisë së nënës Z., i lindur më datë *data e lindjes...*, me vendbanim në P., rr:”...”, pnr., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion-kamariere, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, i pa martuar, sipas të dhënave penale të kësaj gjykate nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse:

I akuzuari B. M.

I. Me datën 11.02.2017, rreth orës 13:30 në rrugën “...” në P., saktësisht përball kafiterisë “Bistro” e cila kafiteri gjendet përball shkollës së mesme “A. Xh.” për shkak të raportit jo të mirë në mes të pandehurit B. dhe të dëmtuarit D.P., i njëjti e kishte sulmuar të dëmtuarin duke e goditur me boks

hekuri në fytyrë, kokë si dhe në pjesë të ndryshme të trupit, me ç'rast i shkakton dëmtime të cilat kualifikohen në lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari H.H.,

II. Me datë, kohë dhe vend të njejtë të përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, për shkak të raportit jo të mirë në mes të pandehurit H. dhe të dëmtuarit D.P., i njejtë e kishte sulmuar të dëmtuarin duke e goditur me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, me ç'rast i shkakton dëmtime të cilat kualifikohen në lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 46, 73, 74 dhe nenit 188 të KPRK-së si dhe në bazë të neneve 365, 366, 369, 370, 450, 453, 463 të KPRK-së, i:

G J Y K O N

Të akuzuarin B.M. me dënim me gjobë në shumë prej 400€ (katërqind/euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarin H.H. me dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind/euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë në afatin e lartcekur, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'u zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'u llogaritet 1(një) ditë burg.

Konform nenit 62 par.1 dhe 2 nën par.2.7 dhe nenit 69 par.1 të KPRK, të akuzuarit B.M. gjithashtu i shqipton edhe këtë:

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohet Boksi i hekurit metalik, me ngjyrë të zezë, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Detyrohen të akuzuarit që në mënyrë solidare në emër të shpenzimeve të procedurës penale-ekspertizës Mjeko-Ligjore të paguajnë shumën prej 20 € (njëzet/euro) ndërsa secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën nga 30 € (tridhjetë/euro) dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç të paguaj shumën nga 30 € (tridhjetë/euro), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

I dëmtuari D.P. me vendbanim në P., rr:"..." për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregull juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.1896/2017 të dt.17.05.2018 kundër të akuzuarve B.M. me vendbanim në P., rr:"...", pnr., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së dhe H.H. me vendbanim në P., rr:"...", pnr., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 02.04.2019, gjatë të cilës prezantuan Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të akuzuarit.

I akuzuari B.M. në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, me të dëmtuarin jemi pajtuar, kërkoj nga gjykata një dënim sa më të butë, i premtroj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritet vepra penale.

I akuzuari H.H. në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, me të dëmtuarin jemi pajtuar, kërkoj nga gjykata një dënim sa më të butë, i premtroj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritet vepra penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve sepse pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave të nenit 248 të KPPRK-së.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet të akuzuarit, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akuzuarit B.M., përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së dhe në veprimet inkriminuese të akuzuarit H.H. përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së, për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penalo-juridik janë përgjegjës dhe të njëjtit i shpalli fajtor, andaj u shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se të akuzuarit në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për herë të parë kanë rënë në kundërshtim me ligjin ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese për të akuzuarit gjykata nuk gjeti. Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 46 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues të akuzuarit Besnik Mahmuti, -konfiskimin e sendit-të armës dhe gjësendeve tjera të mbajtura, në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 62 par.1 dhe 2 nën par.2.7, nenit 69 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u morr në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nënpar 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.387/2018 me dt.02.04.2019

Zyrtare Ligjore
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.